



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KE.nr.2009/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit L.B. , të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Bordi i Drejtorëve “M...” J.S.C., Kryetari i Bordit të Drejtorëve - B.K. , me seli në Prishtinë, me objekt kontesti mbajtja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve, jashtë seancës, me datë 20.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit L.B. , me numër KE.nr.2009/22 (IV.EK.nr.191/22), me objekt kontesti mbajtja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve, ndaj të paditurit Bordi i Drejtorëve “M...” J.S.C., Kryetari i Bordit të Drejtorëve - B.K. .
- II. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi L.B. , përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 24.03.2022, ka parashtruar padi/kërkesë për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Aksionarëve, ndaj të paditurit Bordi i Drejtorëve “M...” J.S.C., Kryetari i Bordit të Drejtorëve - B.K. .

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit L.B. , me datën 02.06.2022, me anë të parashtrësës, e ka njoftuar gjykatën se tërheq padinë për lëndën KE.nr.2009/22 (IV.EK.nr.191/22), të datës 24.03.2022, kundër të paditurit Bordi i Drejtorëve “M...” J.S.C., Kryetari i Bordit të Drejtorëve - B.K. , për shkak se Kuvendi Vjetor i Aksionarëve është mbajtur dhe paditësi në mënyrë të

ligjshme e ka realizuar qëllimin e tij, andaj paditësi e tërheq padinë për shkak të mungesës së interesit juridik për ndjekjen e kësaj çështje në gjykatë.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, në kuptim të nenit 261 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2009/22, datë 20.09.2022.

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.